



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2586/Prot.

Tiranë, më 23.10.2025

VENDIM

Nr. 320, Datë 20.10.2025

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE QË PLOTËSOJNË KUSHTET LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR DREJTUES NË PROKURORINË E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.10.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për miratimin e listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore të kandidimit për Drejtues në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2556 prot., datë 17.10.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi Relatorin Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim Këshilli*) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Me Vendimin nr. 318, datë 16.12.2022, "*Për emërimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar*", Këshilli ka emëruar prokurorin Altin Dumani, si Drejtues në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për një mandat 3 (tre) vjeçar, mandat i cili mbaron në datë 18.12.2025.
3. Në përputhje me procedurat ligjore përkatëse, me Vendimin nr. 286, datë 17.09.2025, "*Për shpalljen e vendit vakant për Drejtues të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar*", Këshilli shpalli fillimin e procedurave të ngritjes në detyrë për zgjedhjen e Drejtuesit të ri të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
4. Në datë 17.09.2025, në faqen zyrtare të internetit të Këshillit u publikua *thirrja për kandidim* për pozicionin Drejtues në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, drejtuar të gjithë prokurorëve të kësaj strukture që plotësojnë kriteret ligjore, për të aplikuar deri në datën 08.10.2025, ora 24:00.
5. Në mbyllje të këtij afati kohor, pas verifikimeve të kryera rezulton, se kanë aplikuar katër prokurorë, kandidatë (të renditur sipas rendit alfabetik):
 - Adnan Xholi;
 - Doloreza Musabelliu;
 - Elvin Gokaj;
 - Klodjan Braho.
6. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës mori në shqyrtim kandidaturat dhe verifikoi plotësimin e kushteve të kandidimit për ngritjen në detyrë për pozicionin Drejtues në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, kushte të cilat janë:
 - i. të jetë prokuror në Prokurorinë e Posaçme;
 - ii. të mos jetë drejtuesi aktual i Prokurorisë së Posaçme;
 - iii. të ketë paraqitur Platformën sipas shpalljes, si dhe;
 - iv. të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

7. Katër kandidatët plotësojnë të gjitha kushtet ligjore të kandidimit të cituara më sipër, pasi ata ushtrojnë aktualisht detyrën si prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, nuk mbajnë pozicionin e drejtuesit aktual të Prokurorisë së Posaçme, kanë paraqitur platformat e tyre sipas kërkesave të përcaktuara në shpallje nga pikëpamja formale, si dhe pas verifikimit të regjistrimit disiplinor të mbajtur nga Komisioni i Disiplinës, asnjëri prej tyre nuk ka masë disiplinore në fuqi. Këta kandidatë kanë kaluar më parë procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim përfundimtar duke u konfirmuar në detyrë.
8. Këshilli konstaton se, kandidatët të cilët plotësojnë kushtet ligjore të kandidimit për vendin vakant për Drejtues në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas rendit alfabetik, janë si më poshtë:
 1. Adnan Xholi;
 2. Doloreza Musabelliu;
 3. Elvin Gokaj;
 4. Klodjan Braho.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 148/dh, pika 3, 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa "a", të Kushtetutës, në nenin 15, pika 1, të Ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", i ndryshuar, në nenin 52, pikat 1 dhe 5, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166 dhe 189, pika 1, germa "a", të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, dhe në nenet 5, pikat 1 dhe 7, si dhe 37, të Vendimit nr. 303, datë 19.09.2023, "Për miratimin e Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar", me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

- I. Miratimin e listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore të kandidimit për Drejtues në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, si më poshtë:
 1. Adnan Xholi;
 2. Doloreza Musabelliu;
 3. Elvin Gokaj;
 4. Klodjan Braho.
- II. Të njoftohen me këtë vendim kandidatët e mësipërm.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë sot më 20.10.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erion Fejzulla

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj